



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2022:011082

Datë: 24.05.2024

Numri i dokumentit: 05734638

KPPP.nr.1604/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, gjyqtari Arnis Dumani, në çështjen përbarimore të kreditorit Komuna Hani i Elezit, me seli në Hani Elezit, kundër debitorit Fabrika e Stiroporit “Kosovaplast” SH.P.K., me numër të regjistrimit të biznesit 70047975 me adresë në Hani Elezit, rr. “11 Qershori”, me pronarë A.D., me adresë në Kodrën e Diellit, rr. “Rifat Bugjeviq” hyrja 1, nr.16, dhe “Kosovaplast – B” SH.P.K., me numër të regjistrimit të biznesit 70748126 me adresë në Hani Elezit, rr. “11 Qershori”, i përfaqësuar nga Z.H., me vendbanim në Hani Elezit, fshati Seçishtë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Mimoza Kuka Bushi, avokat nga Kaçaniku, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përbarimor Plotësues P.nr.747/15, të datës 03.05.2019, të Përbaruesit Privat Flamur S. Bogaj, me seli në Prishtinë, jashtë seancës, më datë 24.05.2024 mori këtë:

A K T V E N D I M

- I. APROVOHET në tërësi si i bazuar prapësimi i debitorëve Fabrika e Stiroporit “Kosovaplast” SH.P.K., me pronarë A.D., “Kosovaplast – B” SH.P.K.,”, i përfaqësuar nga Z.H., ushtruar ndaj Urdhrit Plotësues Përbarimor P.nr.747/15 të datës 03.05.2019, të Përbaruesit Privat Flamur S. Bogaj.
- II. ANULOHET Urdhri Plotësues Përbarimor P.nr.747/15 i datës 03.05.2019, i lejuar nga Përbaruesi Privat Flamur S. Bogaj.

A r s y e t i m

Përbaruesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit të datës 04.12.2015, ka lëshuar Urdhrin Përbarimor P.nr.747/15, të datës 04.12.2015 si dhe Urdhrin Plotësues P.nr.747/15, të datës 03.05.2019 me të cilin ka lejuar përbarimin në bazë të dokumenteve përbarimore Aktvendimit të Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, me të cilin ka urdhëruar debitorin e parë që

t'ia paguaj kreditorit në emër të kompensimit për taksë komunale shumë prej 12,500.00€ (dymbëdhjetë mijë e pesëqind euro) dhe debitorin e dytë që t'ia paguaj kreditorit në emër të kompensimit për taksë komunale shumë prej 9,500.00€ (nëntëmijë e pesëqind euro).

Debitori në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor, ka kundërshtuar në tërësi urdhrin përmbartimor duke theksuar se procedura përmbartimore e iniciuar sipas urdhrin plotësues të datës 03.05.2019 është në tërësi e kundërligjshme. Po ashtu ka shtuar se edhe sikur urdhri të ishte i ligjshëm i njëjti nuk do të mund të vazhdonte të ishte në fuqi për faktin se borxhi për të cilin kërkohet përmbartimi është parashkruar pasi që kanë kaluar më shumë se tre vite dhe konsideron se ka kaluar afati brenda të cilit do të mund të kërkohet kompensimi. Gjykatës i ka propozuar që urdhrin përmbartimorë ta shfuqizoj.

Kreditori në përgjigjen në prapësim të paraqitur brenda afatit ligjor, ka deklaruar se nuk qëndrojnë pretendimet e debitorit në prapësim dhe se urdhri i lëshuar nga përmbartuesi privat është i drejtë dhe i ligjshëm. Tutje ka kundërshtuar pretendimin e debitorit se borxhi është parashkruar për shkak të kalimit të afatit ligjor për kërkimin e borxhit si dhe ka potencuar se prapësimi i debitorëve është i pas asfatshëm pasi që i njëjti nuk është ushtruar ndaj urdhrin për të cilin është vendosur përmes vendimit PPP.nr.1/16.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, përgjigjes në prapësim të kreditorit dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore, (tutje LPP) gjeti se prapësimi i debitorit është në tërësi i bazuar andaj të njëjtin e aprovoi dhe vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi, për shkaqet si në vijim:

Sipas vlerësimit të gjykatë sipas propozimit të kreditorit më 04.12.2015 ishte lëshuar urdhri për përmbartim P.nr.747/15, ndaj debitorëve të përmbartimit, Sh.Sh., A.D., Smajl Deshishku dhe Z.H., ndaj këtij urdhri debitori Sh.Sh. kishte ushtruar të drejtën e tij për prapësim, me c'rast Gjykata Themelore në Ferizaj, Dega në Kaçanik përmes Aktvendimit PPP.nr.1/16 të datës 11.10.2017 kishte aprovuar prapësimin e debitorit Sh.Sh. dhe Urdhrin Përmbartimorë P.nr.747/15 të datës 04.12.2015 e kishte anuluar.

Pas anulimit të këtij urdhri, kreditori kishte paraqitur precizim të propozimit për përmbartim, ku duke vepruar sipas këtij propozimi përmbartuesi privat Flamur S.Bogaj, kishte nxjerr Urdhrin Plotësues P.nr.747/15 të datës 03.05.2019 ku kishte obliguar debitorët Fabrika e Stiroporit "Kosovaplast" SH.P.K., me pronarë A.D. dhe "Kosovaplast – B" SH.P.K., ", i përfaqësuar nga

Z.H., që t'ia paguaj kreditorit në emër të kompensimit për taksë komunale shumë prej 12,500.00€ (dymbëdhjetë mijë e pesëqind euro) dhe debitorin e dytë që t'ia paguaj kreditorit në emër të kompensimit për taksë komunale shumë prej 9,500.00€ (nëntëmijë e pesëqind euro).

Ndaj këtij plotësimi debitori "Kosovaplast – B" SH.P.K., kishte ushtruar prapësim, i cili është objekt shqyrtimi i kësaj gjykate, e për të cilin kishte vendosur fillimisht Gjykata Themelore në Ferizaj, Dega në Kaçanik, vendim i cili ishte anuluar nga Gjykata e Apelit përmes vendimit PPP.nr.89/19 dhe çështja ishte kthyer në rigjykim dhe rivendosje.

Sipas vlerësimit të gjykatës, Urdhri Përmbarrimor P.nr.747/15 i datës 04.12.2015 ishte anuluar nga Gjykata Themelore në Ferizaj, Dega në Kaçanik, andaj Urdhri Plotësues Përmbarrimor P.nr.747/15 i datës 03.05.2019, i nxjerr nga Përmbarruesi Privat Flamur S. Bogaj duhet të anulohet për faktin se lidhur me të njëjtin është vendosur me Aktvendimin PPP.nr.1/16 të datës 11.10.2017 të nxjerr nga Gjykata Themelore në Ferizaj, Dega në Kaçanik dhe i njëjti përbën çështje të gjykuar.

Gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi duke iu referuar nenit 43, par.4 të LPP-së përcaktohet se: *"...Në lidhje me ankesën që ngrehë kundërshtimin ndaj urdhrin të përmbarrueshmërisë së nxjerrë nga përmbarruesi privat, Gjykata që kryen rishikimin e procedurës së përmbarrimit rishikon nëse janë plotësuar kushtet për nxjerrjen e atij urdhri nga përmbarruesi privat. Nëse Gjykata përcakton se nuk janë plotësuar kushtet për nxjerrjen e urdhrin për përmbarrim nga përmbarruesi privat, Gjykata shfuqizon urdhrin me vendim"*.

Andaj nga të lartcekurat, gjykata vlerëson se në rastin konkret Urdhri Plotësues P.nr.747/15 i datës 03.05.2019, është nxjerr në kundërshtim me dispozitat ligjore, pasi që lidhur me Urdhrin Përmbarrimor P.nr.747/15 të datës 04.12.2015 ishte vendosur nga Gjykata Themelore në Ferizaj, Dega në Kaçanik, andaj Urdhri Plotësues Përmbarrimor P.nr.747/15 i datës 03.05.2019, i nxjerr nga Përmbarruesi Privat Flamur S. Bogaj duhet të anulohet për faktin se lidhur me këtë objekt të përmbarrimit është vendosur me Aktvendimin PPP.nr.1/16 të datës 11.10.2017 të nxjerr nga Gjykata Themelore në Ferizaj, Dega në Kaçanik.

Nga arsyet e paraqitura më lartë, dhe duke u bazuar në nenin 73 par.1 dhe par. 3 të LPP-së, nenin 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.1604/22, datë 24.05.2024

Gjyqtari
Arnis Dumani

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimi të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.